REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT

për rezultatet e konsultimit publik të projektligjit

"PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 73/2021 "PËR HEDHJEN NË TREG DHE MBIKQYRJEN E ARTIKUJVE PIROTEKNIKË"

1. Titulli i projektligjit

"Për disa shtesa në ligjin nr. 73/2021 "Për hedhjen në treg dhe mbikqyrjen e artikujve piroteknikë".

Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar çështjen e parashikimit të tarifave të aplikimit të cilat janë të domosdoshme për të mbuluar jo vetëm kostot administrative që lidhen me procesin e aplikimit, por edhe shpenzimet që lidhen me inspektimet dhe kontrollet që kryhen nga Autoriteti i Kontrollit Shteteror të Eksporteve. Këto tarifa synojnë të sigurojnë funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të autoritetit, duke garantuar një nivel të lartë të transparencës, llogaridhënies dhe përputhshmërisë me standardet ligjore dhe rregullatore në fuqi.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 73/2021 "Për hedhjen në treg dhe mbikqyrjen e artikujve piroteknikë" është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP) nga data 6 Tetor 2026 deri në datë 3

Nëntor 2026, duke respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh pune.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.
Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.
Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Procesi i konsultimit publik për projektligjin është zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 146/2014 dhe VKM nr. 584/2021.

Projektligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 73/2021 "Për hedhjen në treg dhe mbikqyrjen e artikujve piroteknikë" u konsultua nëpërmjet metodave të përshkruara më poshtë:

- **Nëpërmjet RENJK:**

Publikimi në RENJK u bë duke respektuar afatin 20 ditor, nga data 6 Tetor 2026 deri më datë 3 Nëntor 2026, për dhënien e sugjerimeve/komenteve mbi draftin e projektligjit.
Publikimi i draftit në portalin zyrtar të konsultimeve publike ka regjistruar 202 lexime në RENJKP.

- **Nëpërmjet adresës së emalit:**

Me qëllim lehtësimin e dhënies së komenteve/sugjerimeve nga çdo i interesuar, në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, krahas draftit të projektligjit është vënë në dispozicion edhe adresa elektronike konsultim.publik@mod.gov.al.

- **Nëpërmjet adresës postare: "Rruga e Dibrës, Garnizoni "Skënderbej", Tiranë":**

Çdo palë e interesuar mund të dërgonte në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Mbrojtjes të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e

projektligjit.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.
Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.
Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Nuk ka patur palë të interesuara gjatë procesit të konsultimit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimit e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nuk ka patur komente të mbledhura gjatë fazës së konsultimit publik, për projektligjin, ndërsa rezultojnë 202 shikime në RENJKP.

Komentet e ardhura nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera janë gjeneruar nëpërmjet sistemit e-Akte.

Nr.	Çështja e adresuar	Komenti i marrë	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi